



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3555/16 prot.

Datë 10.02.2026

V E N D I M
Nr. 236/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.02.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 20/2026, datë 07.01.2026 për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjetë mije e nëntëdhjetë e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “KRIJON” SHPK me Nipt. K12023001A dhe adresë: Rruga e Elbasanit, nr.57, Çollak, 1044, Tiranë

Operatori ekonomik “BionicTech” SHPK me Nipt. M41406021N dhe adresë: Rruga “Stavri Themeli”, ZK 8220, vol.12, fq.23 me nr. Pasurie 8/307-N2, Tiranë

Autoriteti kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datë 07.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 20/2026, ku vendosi: [.....]

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “KRIJON” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK, duke e kualifikuar atë.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KRIJON” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.” [...]

I.2. Më datë 29.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mbasi shqyrtoi kërkesën e autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a për rishikim të vendimit 20/2026, datë 07.01.2026 vendosi:

[.....]

1. Të mos pranojë kërkesën e autoritetit kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, për rishikim të vendimit të KPP nr.20/2026, datë 07.01.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjete mije e nentëdhjete e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [.....]

I.3. Me shkresën nr. 4251/39 prot., datë 04.02.2026, protokolluar me tonën nr. 3555/13 prot., datë 06.02.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 20/2026 datë 07.01.2026 duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e datës 03.02.2026 “Për rivlerësimin e ofertave të paraqitura në procedurën me

objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, bazuar në vendimet e KPP nr.20/2026 dhe nr.168/2026”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 4251/39 prot., datë 04.02.2026, protokolluar me tonën nr. 3555/13 prot., datë 06.02.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 20/2026 datë 07.01.2026 duke i bashkëngjitur shkresës procesverbalin e datës 03.02.2026 “Për rivlerësimin e ofertave të paraqitura në procedurën me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, bazuar në vendimet e KPP nr.20/2026 dhe nr.168/2026”.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik duke kualifikuar operatorin ekonomikë “Bionictch” SHPK në përputhje me vendimin e KPP Nr. 20/2026, datë 07.01.2026.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor”, me nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote”, Loti 4: “Blerje enë

laboratorike”, me nr. REF-63106-09-30-2025, me fond limit: 27,126,899 (njëzet e shtatë milion e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 280 092 (dyqind e tetëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e dy) euro pa TVSH, zhvilluar në datë 10.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a..

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiovent Zguro

